



MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM – (MpB)

në mes të:

**Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës me regjistrim
Nr: 5200122-6 – në tekstin e mëtejme i referuar si "IADK"**

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË USHQIMORE

Pranuar me dt. 02.09.2024			
Njesia organ.	Numer	Nr.Ekzempl.	Vlera
	315		

dhe:

**Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore "FTU" në kuadër të
Universitetit të Mitrovicës "ISA BOLETINI" –
në tekstin e mëtejme i referuar si "FTU"**

I. Lënda e MpB

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) dhe Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore (FTU) në kuadër të Universitetit të Mitrovicës "ISA BOLETINI" janë pajtuar të bashkëpunojnë ngushtë në fushën e arsimit dhe praktikës profesionale në sektorin e teknologjisë ushqimore, duke qenë të hapur për çdo formë të mundshme bashkëpunimi.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi përfshin studentët, stafin akademik dhe menaxherial të FTU-së, stafin e IADK-së, si dhe kandidatët potencialë që do të ndjekin trajnimet profesionale të organizuara nga IADK.

Të dyja palët angazhohen të kontribuojnë në zhvillimin e kapaciteteve profesionale në proceset e hulumtimit dhe trajnimit në fushën e teknologjisë ushqimore, në përputhje me interesat e përbashkëta.

Kjo marrëveshje për bashkëpunim ka për qëllim të përcaktojë kushtet dhe termat e bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet IADK-së dhe FTU-së në kuadër të Universitetit të Mitrovicës "ISA BOLETINI" për periudhën nga 02/09/2024 deri më 31/12/2027.

II. Obligimet e IADK-së

IADK do të kontribuojë në koordinimin dhe mbikëqyrjen e logjistikës për aktivitetet e organizuara në IADK, duke përfshirë transportin, akomodimin dhe organizimin e takimeve me palët përkatëse.

Kontributet nga IADK janë si vijon:

- Të informoj në kohë Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore (FTU) për periudhën e mbajtjes së trajnimeve praktike me kandidatët në laboratorët e FTU-së;
- Të njoftoj FTU-në për mundësitë e aplikimit në organizata të ndryshme për fitimin e granteve;
- IADK mbështet partneritetin me FTU-në dhe studentët për mundësinë e bashkëpunimit në kuadër të projekteve të Bashkimi Evropian (BE);
- Kandidatët e IADK-së që do të realizojnë punën praktike në FTU nuk do të kenë ndonjë obligim për kompensim për shërbimin e pranuar;
- IADK do të njoftojë në kohë (FTU) për numrin e ditëve të trajnimeve në përputhje me grupet që do të formohen;
- IADK do të mundësojë punë praktike për studentët e FTU-së në kuadër të projekteve që ndërlidhen me punën praktike të studentëve;

- IADK do të mundësojë shkëmbimin e vizitave studimore për studentët e FTU-së tek përfituesit e IADK-së në kuadër të projekteve të saj dhe në Qendrën e Aftësisit Profesional në IADK;
- Pas përfundimit të punës praktike, IADK do të lëshojë një dëshmi për studentët e FTU-së, e cila do të përfshijë të dhënat mbi mbajtjen e punës praktike dhe një vlerësim të performancës;
- Të informoj FTU-në për pjesëmarrjen në konferenca, tryeza, takime dhe trajnime të ndryshme në kuadër të sektorit të teknologjisë ushqimore;
- Të mundësoj shkëmbimin e stafit në kuadër të interesave profesionale në sektorin e teknologjisë ushqimore;
- IADK do të mbështesë aplikimin për bashkëpunime të përbashkëta dhe do të njoftojë FTU-në për mundësitë e bashkëpunimit në projekte të reja që përputhen me objektivat e përbashkëta.
- IADK do t'ju mundësojë dhe ndaj përvojën FTU dhe studenteve të saj qasje në modelet që kanë ngritur IADK dhe që ndërlidhen me ndryshimet klimatike, digjitalizimin në bujqësi dhe agrobiznes.
- IADK me kërkesë dhe interes të FTU mund të ofrojë shërbime me ekspertë të saj (te brendshëm dhe të jashtëm) në tema të caktuara.

III. Obligimet e FTU-së

FTU do të kontribuojë në koordinimin dhe mbikëqyrjen e logjistikës për aktivitetet e organizuara në UMIB, duke përfshirë transportin dhe organizimin e takimeve me palët përkatëse. Kontributet nga FTU janë si vijon:

- Të lejoj përdorimin e hapësirave dhe pajisjeve laboratorike nga ekspertët e IADK-së gjatë trajnimeve me kandidatët, duke u dakorduar paraprakisht për periudhën e mbajtjes së trajnimeve.
- Të vendos në varësi të interesit të FTU-së për të caktuar anëtarë nga stafi për të marrë pjesë në trajnimet që do të organizojë IADK.
- Të siguroj që përfaqësuesit e IADK-së, përfshirë ekspertët nga vende të ndryshme, të kenë qasje në hapësirat e pranimit, analizës dhe përpunimit të produkteve për prezantimin e FTU-së.
- Personi përgjegjës i caktuar nga FTU do të shpjegojë në mënyrë teorike dhe praktike temat e linjës së prodhimit, duke përfshirë: procesin e pranimit të lëndës së parë, marrjen e mostrave për analizë dhe përcaktimin e parametrevë të ndryshme, procesin e pasterizimit të lëndës së parë dhe produkteve përfundimtare, largimin e mbetjeve pas përfundimit të proceseve teknologjike, mirëmbajtjen dhe përdorimin e pajisjeve të punës, ambalazhimin, përgatitjen dhe deponimin e produkteve, si dhe proceset tjera që zhvillohen në kuadër të FTU-së.
- Të demonstrojë dhe shpjegojë tema të tjera sipas moduleve të IADK-së dhe interesimeve të kandidatëve.
- Të informojë studentët e FTU-së për mundësitë e punës praktike dhe të publikojë thirrjet e IADK-së në departamentin dhe faqen zyrtare të internetit të UMIB-it.
- Pas përfundimit të punës praktike, FTU obligohet të lëshojë një dëshmi për kandidatët e IADK-së, e cila do të përfshijë të dhënat mbi mbajtjen e punës praktike dhe një vlerësim të performancës.
- Të informojë IADK-në për pjesëmarrjen në konferenca, tryeza, takime dhe trajnime të ndryshme në kuadër të sektorit të teknologjisë ushqimore.
- Të mundësojë shkëmbimin e stafit në kuadër të interesave profesionale në sektorin e teknologjisë ushqimore dhe të organizojë shkëmbimin e vizitave studimore në hapësirat e FTU-së për stafin dhe kandidatët e IADK-së.



- Te mundësojë dhe lehtësojë studenteve vizitat për marrjen e përvojës te modeleve dhe praktikeve te mira te IADK-se
- Te shoqërojë dhe lehtësojë punën dhe aktivitetet e eksperteve te IADK gjate trajnimeve qe do te zhvillohen tek FTU

IV. Personat Kontaktues

IADK dhe Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore (FTU) do të emërojnë nga një përfaqësues për të facilituar kontaktet më të lehta dhe të drejtpërdrejta ndërmjet dy partnerëve. Këta përfaqësues do të angazhohen drejtpërdrejt në menaxhimin e suksesshëm dhe në përmbushjen në kohë të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi.

IADK do të përfaqësohet nga Drejtori Ekzekutiv i Organizatës, Z. Zenel Bunjaku.

FTU, në kuadër të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", do të përfaqësohet nga stafi i Universitetit, Dr.Sc. Arbër Hyseni

V. Hyrja në fuqi dhe ndërprerja

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi (MpB) do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit dhe është i vlefshëm deri më 31.12.2027.

Çdo dispozitë e kësaj marrëveshjeje mund të amendamentohet ose rishikohet nga të dy palët, pas konsultimeve dhe marrëveshjeve të përbashkëta. Çdo çështje që nuk është e përfshirë në këtë dokument do të zgjidhet nëpërmjet marrëveshjeve të përbashkëta.

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje ose pakënaqësie nga ndonjëra palë, MpB mund të ndërpritet brenda tridhjetë (30) dite pas njoftimit me shkrim.

VI. Mospajtimet

Të dy palët në çdo kohë do të respektojnë dhe nderojnë kodin e sjelljes të partnerit të tyre, me kujdes të veçantë në pozicionet e paraqitura më lartë.

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK)


.....
Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv

Vushtrri 02/09/ 2024

**Universiteti i Mitrovicës "ISA BOLETINI"
Fakultetit i Teknologjisë Ushqimore**


.....
Prof. asoc. dr. Mensur Kelmendi
Dekan FTU

Mitrovicë 02. 09 2024